


Tregtia e jashtme e mallrave

Mars 2022

Tiranë, më 19 Prill 2022: Në Mars 2022 eksportet e mallrave arritën vlerën 48 mld lekë, duke u rritur me 50,4 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 28,0 %, në krahasim me Shkurt 2022. Importet e mallrave arritën vlerën 84 mld lekë, duke u rritur me 29,7 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 21,7 %, në krahasim me Shkurt 2022. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 36 mld lekë, duke u rritur me 9,7 %, krahasuar me Mars 2021 dhe me 14,4 %, në krahasim me Shkurt 2022.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë tremujor eksportet e mallrave arritën vlerën 120 mld lekë, duke u rritur me 49,6 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 207 mld lekë, duke u rritur me 27,9 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 87 mld lekë, duke u rritur me 6,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Mars 2022, në rritjen e eksporteve prej 50,4 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +20,3 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +12,7 pikë përqindje dhe “Tekstile dhe këpucë” me +6,7 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Mars 2022




Eksportet, gjatë këtij tremujori janë rritur me 49,6 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +18,5 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +14,4 pikë përqindje, dhe “Tekstile dhe këpucë” me +6,4 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Mars 2022, në rritjen e importeve prej 29,7 %, krahasuar me Mars 2021, kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +14,2 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +7,2 pikë përqindje dhe “ Ushqime, pije, duhan” me +4,2 pikë përqindje. Ndërsa grupi që ka ndikuar negativisht tek importet është: “Produkte kimike dhe plastike” me -0,1 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Mars 2022



Si tremujorë, importet janë rritur me 27,9 %, krahasuar me tremujorin e parë 2021. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +10,7 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +7,3 pikë përqindje dhe “ Ushqime, pije, duhan” me +4,3 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Mars 2022, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Mars 2021 janë: Italia (67,1 %), Kosova (25,2 %) dhe SHBA (9 herë). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Greqia (6,0 %) dhe Spanja (44,6 %).

Gjatë këtij tremujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (54,5 %), Kosova (52,0 %) dhe Gjermania (123,3 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Spanja (66,8 %) dhe Turqia (19,7 %).

Në muajin Mars 2022, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Mars 2021 janë: Italia (0,8 %), Turqia (53,5 %) dhe Greqia (29,5 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: SHBA (9,5 %), Kroaci (22,0 %) dhe Zvicër (19,0 %).

Gjatë këtij tremujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (12,7 %), Turqia (52,7 %) dhe Kina (9,1 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: SHBA (20,2 %) dhe Zvicra (29,4 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Mars 2022



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 59,8 %, të gjithë tregtisë. Në Mars 2022, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 71,3 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 53,2 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (30,4 %), Turqia (9,0 %), Greqia (6,7 %) dhe Kina (6,5 %).

Shkëmbimet tregtare, për tremujorin 2022, me vendet e BE-së zënë 60,9 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Shkurt – Mars 2022, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 73,0 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 54,0 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (31,8 %), Turqia (8,3 %), Gjermania (7,0 %) dhe Greqia (6,6 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Mars 2022

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2021		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	03 - 19	28	2,7	56	1,4	-28	49,6
	Janar- Mars 19	72	3,0	148	1,3	-76	48,8
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	25	10,6	52	3,9	-27	48,3
	03 - 20	18	-36,0	44	-20,8	-27	40,1
	Janar- Mars 20	66	-8,9	138	-6,7	-72	47,7
2021	01 - 21	24	3,1	45	8,4	-22	52,3
	02 - 21	25	-0,9	52	0,9	-27	47,4
	03 - 21	32	78,1	64	45,3	-33	49,2
	Janar- Mars 21	80	21,9	162	27,9	-82	49,5
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6
	02 - 22	37	50,5	69	31,5	-31	54,3
	03 - 22	48	50,4	84	29,7	-36	57,1
	Janar- Mars 22	120	49,6	207	27,9	-87	57,9

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Mars 2022

	Eksporte				Importe			
	Mars 2021	Mars 2022	Jan, - Mars 2021	Jan, - Mars 2022	Mars 2021	Mars 2022	Jan, - Mars 2021	Jan, - Mars 2022
Vendet e BE-së	23.229	34.003	60.691	87.612	37.239	44.498	92.457	111.880
Austri	233	296	528	993	635	468	1.438	1.533
Gjermani	2.266	2.774	4.326	9.659	4.488	5.360	11.859	13.344
Greqi	2.106	1.979	4.594	5.673	5.230	6.773	13.230	16.041
Itali	13.127	21.928	36.172	55.902	17.795	17.943	42.621	48.042
Spanjë	1.620	898	5.537	1.838	852	1.477	2.027	3.430
Kroaci	208	1.023	734	2.048	1.062	828	1.644	1.651
Të tjera të BE-së	3.670	5.104	8.801	11.499	7.177	11.648	19.639	27.839
Mbretëri e Bashkuar	72	116	147	318	577	588	1.228	1.605
Kinë	775	1.963	2.257	3.769	5.612	6.606	14.734	16.072
Kosovë	3.072	3.844	6.557	9.965	856	1.522	2.015	3.479
Maqedonia e Veriut	1.074	1.228	1.982	4.909	951	1.795	2.261	3.663
Rusi	-	-	-	2	786	972	2.167	3.223
SHBA	291	2.809	1.182	3.623	1.147	1.038	3.434	2.740
Turqi	450	552	1.478	1.187	7.332	11.256	17.051	26.043
Ukrainë	56	97	125	177	186	115	718	1.373
Zvicër	409	412	642	1.035	791	641	2.908	2.055
Të tjera	2.289	2.690	5.162	7.413	9.021	14.601	23.190	35.210
Gjithsej	31.717	47.715	80.225	120.012	64.497	83.631	162.163	207.343

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Mars 2022

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Mars 2021	Mars 2022	Jan, - Mars 2021	Jan, - Mars 2022	Mars 2021	Mars 2022	Jan, - Mars 2021	Jan, - Mars 2022
Gjithsej	31.717	47.715	80.225	120.012	64.497	83.631	162.163	207.343
Ushqime, pije, duhan	3.492	4.170	8.808	10.484	10.373	13.056	26.085	33.070
Minerale, lëndë djegëse, en,el,	7.333	11.376	15.561	30.406	4.637	13.796	14.501	31.871
Produkte kimike dhe plastike	914	1.864	2.234	4.654	10.843	10.751	25.442	26.078
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	182	286	473	759	1.364	1.630	2.924	4.159
Prodhime druri dhe letre	799	1.160	2.076	3.143	2.350	2.992	5.604	7.708
Tekstile dhe këpucë	9.615	11.732	27.283	32.435	7.351	8.878	19.310	22.810
Materiale ndërtimi dhe metale	6.076	12.509	14.975	26.566	9.807	14.441	23.118	34.884
Makineri, pajisje dhe pj, këmb,	2.447	3.358	6.473	8.706	14.893	15.116	37.906	39.447
Të tjera	859	1.259	2.342	2.858	2.878	2.970	7.271	7.316

Tab.4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Mars 2022

	Itali		Kosovë		Spanjë		Greqi	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
Gjithsej	36.172	55.902	6.557	9.965	4.326	9.659	4.594	5.673
Ushqim, pije duhan	2.650	2.796	781	1.134	397	462	915	924
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	407	9.536	1.607	2.053	1.241	5.807	1.382	933
Produkte kimike dhe plastike	563	1.072	667	1.237	10	10	176	238
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	391	715	4	3	24	1	4	4
Prodhime druri dhe letre	1.387	1.825	175	383	58	74	245	485
Tekstile dhe këpucë	21.731	25.265	53	50	1.718	2.048	1.278	1.469
Materiale ndërtimi dhe metale	4.744	8.569	2.586	4.413	240	515	451	1.427
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	3.142	4.671	356	387	559	597	31	31
Të tjera	1.157	1.454	328	306	79	143	111	162

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Mars 2022

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
Gjithsej	42.621	48.042	17.051	26.043	14.734	16.072	13.230	16.041
Ushqim, pije duhan	5.215	6.323	1.548	1.488	202	345	3.637	4.212
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	3.113	2.288	317	1.365	5	1	2.375	3.415
Produkte kimike dhe plastike	5.575	5.546	2.296	2.619	1.922	1.684	2.071	2.076
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	2.392	3.387	83	125	159	172	9	5
Prodhime druri dhe letre	1.382	1.701	805	1.162	203	226	770	1.012
Tekstile dhe këpucë	8.894	11.451	3.844	4.218	2.627	2.531	723	959
Materiale ndërtimi dhe metale	5.747	6.190	4.267	11.521	1.295	1.887	2.518	3.235
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	8.965	9.471	2.461	2.389	6.866	7.709	639	781
Të tjera	1.339	1.686	1.430	1.155	1.455	1.517	488	347

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës, Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor,

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat,

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri